VENDIM
Nr. 59, datë 21.12.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE"[1]

(Ndryshuar me vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

(i përditësuar)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave"; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Rregullorja hyn në fuqi më datë 1 mars 2023.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE

PËR KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË PAGESAVE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti
(ndryshuar neni me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Objekti i kësaj rregulloreje është:

[1] *Kjo rregullore është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/92/BE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 korrik 2014 "Mbi krahasueshmërinë e tarifave në lidhje me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike".*
Numri CELEX 32014L0092, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 257, datë 28.8.2014, faqe 214-246.

a) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave;

b) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave me shërbime bazike dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave me shërbime bazike ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave; si dhe

c) përcaktimi i metodologjisë së përllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

Neni 2

Subjektet

(shtuar togfjalësh me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Subjekte të kësaj rregulloreje janë ofruesit e shërbimeve të pagesave, në kuptim të ligjit nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave", si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja, sipas ligjit nr. 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

Neni 3

Baza ligjore

(ndryshuar neni me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja "e", të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji "Për bankat"); të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave" (më poshtë ligji "Për shërbimet e pagesave") dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike" (më poshtë ligji "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike").

Neni 4

Përkufizime

(ndryshuar pika 1, shtuar pika a/1 dhe ndryshuar togfjalësh në shkronjën "h" të pikës 2 me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

1. *Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit "Për bankat", nenit 5 të ligjit "Për shërbimet e pagesave" dhe nenit 5 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".*

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "llogari pagese" – do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin "Për shërbimet e pagesave";

a/1) "llogari e pagesave me shërbime bazike" - do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike";

b) "mjet i qëndrueshëm komunikimi" - është çdo mjet komunikimi që i mundëson konsumatorit ruajtjen e informacionit adresuar personalisht atij konsumatori, në një mënyrë të tillë që mundëson përdorimin e këtij informacioni si referencë në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme për qëllime të informacionit dhe që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;

c) "shërbimet e lidhura me llogarinë e pagesës" – janë të gjitha shërbimet që lidhen me hapjen, funksionimin dhe mbylljen e një llogarie pagese, përfshirë shërbimet e pagesave dhe transaksionet e pagesave, në lidhje me transaksionet e parashikuara në shkronjën "e" të nenit 4 të ligjit "Për shërbimet e pagesave" dhe kreditë e lidhura me shërbimet e pagesave sipas parashikimeve në nenin 19, pika 4, të ligjit "Për shërbimet e pagesave";

d) "ofruesi marrës i shërbimit të pagesës" – është ofruesi i shërbimit të pagesave, tek i cili transferohet informacioni i kërkuar për të kryer transferimin e llogarisë së pagesave;

e) "ofruesi transferues i shërbimit të pagesës" – është ofruesi i shërbimit të pagesave, i cili transferon informacionin e kërkuar për të kryer transferimin e llogarisë së pagesave;

f) "kredi lidhur me shërbimet e pagesave" nënkupton shumën maksimale të fondeve që tejkalon balancën pozitive në llogarinë e pagesës së konsumatorit dhe të cilën ofruesi i shërbimit të pagesave vë në dispozicion të konsumatorit në formën e një kredie kufi, bazuar në një kontratë me shumë të përcaktuar dhe afat maksimal 12 muaj;

g) "shërbimi i transferimit" – nënkupton transferimin nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesave tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesave, të të paktën njërit prej elementeve të mëposhtme, shoqëruar kjo me mbylljen ose jo të llogarisë së pagesës me ofruesin transferues të shërbimit të pagesave:

i. të informacionit mbi disa ose të gjithë urdhrat për transfertat e kreditit, mandatet e debitimit direkt periodik dhe urdhërpagesat periodike për transferta krediti të ekzekutuara në llogarinë e pagesës,

ii. të një pjesë ose të gjithë balancës kreditore të llogarisë së pagesës, nga një llogari pagese në tjetrën;

h) "konsumator" – do të ketë të njëjtin kuptim të përcaktuar në pikën 18 të nenit 5 të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

Neni 5
Kërkesa të përgjithshme

1. Banka e Shqipërisë harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj, një listë me të paktën 10 dhe jo më shumë se 20 shërbimet më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, të cilat janë subjekt i një tarife. Lista përmban termat dhe përshkrimin për secilin prej shërbimeve të paraqitura në të. Banka e Shqipërisë njofton subjektet e kësaj rregulloreje për hartimin dhe publikimin e listës së shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese.

2. Banka e Shqipërisë, për hartimin e listës të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, merr në konsideratë shërbimet që:

a) përdoren më shpesh nga konsumatorët në lidhje me llogarinë e tyre të pagesës;

b) gjenerojnë koston më të lartë për konsumatorët, si në terma të përgjithshëm, ashtu edhe për njësi.

3. Banka e Shqipërisë, çdo katër vjet, pas publikimit të listës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, vlerëson dhe, kur është e përshtatshme, përditëson listën e shërbimeve më përfaqësuese të krijuara në përputhje me parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Banka e Shqipërisë njofton subjektet e kësaj rregulloreje për çdo përditësim të listës së shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë raporte tremujore mbi tarifat e aplikuara për shërbimet e përfshira në listën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Këto raporte duhet të raportohen jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të tremujorit, në përputhje me formatin e standardizuar të hartuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave në rast të ndonjë ndryshimi të tarifave ose hedhjes në treg të produkteve të reja, përpara afatit të raportimit të përcaktuar në pikën 4

të këtij neni, pas marrjes së vendimit raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, tarifat e reja të zbatueshme.

6. Banka e Shqipërisë publikon në mënyrë të përmbledhur dhe krahasimore, tarifat e aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave për shërbimet e përfshira në listën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

7. Kërkesat e përcaktuara në rregulloren nr. 59, datë 29.8.2008, "Për transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare", të ndryshuar, mbi raportimin dhe publikimin e normave të interesit për kreditë dhe depozitat dhe komisionet për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare, mbeten në fuqi pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara të paraqitura në këtë rregullore për raportimin dhe publikimin e tarifave për llogaritë e pagesave.

KREU II
KRAHASUESHMËRIA E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E PAGESËS

Neni 6
Informacioni mbi tarifat edhe termat e standardizuar për konsumatorët

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave i vendosin në dispozicion konsumatorit, në një kohë të përshtatshme dhe të mjaftueshme përpara lidhjes së kontratës për një llogari pagese, në format letër ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, një dokument që përmban informacion mbi tarifat, i cili përfshin termat e standardizuar në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe nëse këto shërbime ofrohen nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, edhe tarifat përkatëse për çdo shërbim. Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të dokumentojnë nënshkrimin e dokumentit nga konsumatori dhe datën e nënshkrimit të tij.

2. Dokumenti që përmban informacion mbi tarifat:

a) është një dokument i shkurtër dhe i veçantë;

b) paraqitet në një mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur karaktere të një madhësie të lexueshme;

c) të jetë jo më pak i kuptueshëm në rast se, pasi është përgatitur fillimisht me ngjyra, të shtypet ose fotokopjohet në bardh e zi;

d) të jetë i shkruar të paktën, në gjuhën shqipe dhe, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër;

e) të jetë i saktë, joçorientues dhe i shprehur në monedhën e llogarisë së pagesës ose, nëse bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një monedhë tjetër;

f) ka titullin "Dokument që përmban informacion mbi tarifat" në krye të faqes së parë;

g) përfshin një pasqyrë që përmban tarifat për shërbimet më përfaqësuese në lidhje me llogarinë e pagesës.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sipas formatit të paraqitur në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

4. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë një ose më shumë shërbime si pjesë të një pakete shërbimesh të lidhura me një llogari pagese, dokumenti që përmban informacion mbi tarifat duhet të paraqesë tarifat për të gjithë paketën, shërbimet e

përfshira në paketë dhe sasinë e tyre, si dhe tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës.

5. Në rastet kur një llogari pagese ofrohet si pjesë e një pakete, së bashku me një produkt ose shërbim tjetër i cili nuk është i lidhur me llogarinë e pagesës, ofruesit e shërbimeve të pagesave informojnë konsumatorët nëse është e mundur të përfitojnë llogarinë e pagesës në mënyrë të veçuar dhe, nëse është e mundur, ofrojnë informacion të veçantë në lidhje me tarifat që lidhen me secilin nga produktet dhe shërbimet e tjera të ofruara në atë paketë që mund të përfitohen në mënyrë të veçuar.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vënë në dispozicion të konsumatorëve, një fjalor të paktën të kushteve të standardizuara të përcaktuara në listën e shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurojnë që fjalori i dhënë është hartuar në gjuhë të qartë, të kuptueshme dhe joteknike dhe që nuk është çorientuese.

7. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, në çdo kohë, dokumentin që përmban informacion mbi tarifat dhe fjalorin. Dokumenti dhe fjalori paraqiten në një formë lehtësisht të përdorshme, përfshirë edhe konsumatorët që nuk janë klientë të ofruesve të shërbimeve të pagesave, në formë elektronike në faqen e tyre të internetit, aty ku është e zbatueshme, si dhe në mjediset e punës së ofruesve të shërbimeve të pagesave, të aksesueshme për konsumatorët. Dokumenti dhe fjalori gjithashtu paraqiten në format letër ose me mjete të tjera të qëndrueshme komunikimi, pa pagesë, me kërkesën e konsumatorit.

Neni 7

Pasqyra mbi tarifat e aplikuara

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave i paraqesin konsumatorit, të paktën çdo vit dhe pa pagesë, një pasqyrë mbi të gjitha tarifat e aplikuara, si dhe, kur është e zbatueshme, informacion në lidhje me normat e interesit të parashikuara në shkronjat "c" dhe "d" të pikës 3 të këtij neni, për shërbimet e lidhura me një llogari pagese. Kur është e zbatueshme, ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin termat e standardizuar, të përcaktuara në listën e referuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave informojnë konsumatorët mbi pasqyrën e tarifave, sipas mënyrës së rënë dakord në kontratë. Pasqyra e tarifave paraqitet në format letër, me kërkesën e konsumatorit.

3. Pasqyra mbi tarifat e aplikuara përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) tarifën për njësi, të aplikuar për secilin shërbim dhe numrin e rasteve që shërbimi është përdorur gjatë periudhës përkatëse, dhe nëse shërbimet janë të kombinuara në një paketë, tarifat e aplikuara për paketën në tërësi, numrin e rasteve kur tarifa e paketës është aplikuar gjatë periudhës përkatëse dhe tarifat shtesë të aplikuara për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës;

b) shumën totale të tarifave të aplikuara gjatë periudhës përkatëse për secilin shërbim, secilën paketë të shërbimeve të ofruara dhe shërbimet që tejkalojnë sasinë e mbuluar nga tarifat e paketës;

c) normën e interesit të kredisë kufi të aplikuar për llogarinë e pagesës dhe shumën totale të interesit të aplikuar në lidhje me kredinë kufi gjatë periudhës përkatëse, kur është e zbatueshme;

d) normën e interesit kreditor të aplikuar për llogarinë e pagesës dhe shumën totale të interesit të fituar gjatë periudhës përkatëse, kur është e zbatueshme;

e) shumën totale të tarifave të aplikuara për të gjitha shërbimet e ofruara gjatë periudhës përkatëse.

4. Pasqyra mbi tarifat e aplikuara:

a) paraqitet në një mënyrë të qartë dhe të lehtë për t'u lexuar, duke përdorur karaktere të një madhësie të lexueshme;

b) të jetë e saktë, joçorientuese dhe e shprehur në monedhën e llogarisë së pagesës ose, nëse bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një monedhë tjetër;

c) ka titullin "Pasqyra mbi tarifat e aplikuara" në krye të faqes së parë; dhe

d) të jetë e shkruar të paktën, në gjuhën shqipe ose, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vendosin në dispozicion të konsumatorëve, pasqyrën e tarifave të përcaktuar në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, sipas formatit të paraqitur në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Informacioni për konsumatorët

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave, në informacionin kontraktor dhe promocional për konsumatorët, kur është e zbatueshme, përdorin termat e standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të kësaj rregulloreje. Ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të përdorin emërtime tregtare në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat dhe në pasqyrën e tarifave, me kusht që emërtime të tilla të përdoren përveç termave të standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, si një përcaktim dytësor i atyre shërbimeve, të paraqitur në kllapa ose në madhësi shkrimi më të vogël.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave mund të përdorin emërtime tregtare për të përcaktuar shërbimet e tyre në informacionin e tyre kontraktor dhe promocional për konsumatorët, me kusht që ata të identifikojnë qartë, kur është e zbatueshme, termat përkatës të standardizuar të përcaktuar në listën e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

KREU III

TRANSFERIMI I LLOGARIVE TË PAGESËS

Neni 9

Ofrimi i shërbimit të transferimit

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë shërbimin e transferimit midis llogarive të pagesave të mbajtura në të njëjtën monedhë, për të gjithë konsumatorët që hapin ose mbajnë një llogari pagese me një ofrues të shërbimeve të pagesave.

2. Shërbimi i transferimit të llogarive të pagesave nuk ofrohet nëse në llogarinë e pagesës së konsumatorit ka një urdhër bllokimi ose sekuestro nga institucionet që e gëzojnë këtë të drejtë me ligj.

Neni 10

Autorizimi i konsumatorit për transferimin

1. Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës kryen shërbimin e transferimit pas marrjes së autorizimit nga konsumatori. Në rastin kur llogaria zotërohet nga dy ose më shumë persona, autorizimi merret nga secili prej tyre.

2. Autorizimi duhet të jetë të paktën, në gjuhën shqipe ose, nëse është rënë dakord shprehimisht ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave, edhe në një gjuhë tjetër.

3. Autorizimi lejon që konsumatori:

a) të sigurojë ofruesin transferues të shërbimit të pagesës me pëlqimin specifik për të kryer secilin nga veprimet e parashikuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje; dhe

b) të sigurojë ofruesin marrës të shërbimit të pagesës me pëlqimin specifik për të kryer secilin nga veprimet e parashikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

4. Autorizimi i lejon konsumatorit të identifikojë në mënyrë specifike transfertat e kreditit në mbërritje, urdhërpagesat periodike për transferta krediti dhe mandatet e debitimit direkt që do të transferohen.

5. Autorizimi gjithashtu i lejon konsumatorit të specifikojë datën nga e cila urdhërpagesat periodike për transferta krediti dhe debitimet direkte do të ekzekutohen nga llogaria e pagesës së hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës. Kjo datë do të jetë të paktën 6 (gjashtë) ditë pune pas datës në të cilën ofruesi marrës i shërbimit të pagesës merr dokumentet e transferuara nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës, në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

6. Autorizimi nga konsumatori duhet të jetë me shkrim, në letër ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, dhe një kopje e autorizimit i vihet në dispozicion konsumatorit.

Neni 11

Kërkesat e ofruesit marrës të shërbimit të pagesave ndaj ofruesit transferues të shërbimit të pagesave

Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, brenda dy ditëve të punës nga marrja e autorizimit të parashikuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje, i kërkon ofruesit transferues të shërbimit të pagesës të kryejë veprimet e mëposhtme, nëse parashikohet në autorizimin e konsumatorit:

a) të dërgojë tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës dhe, nëse kërkohet specifikisht nga konsumatori, te vetë konsumatori, një listë të urdhërpagesave periodike për transferta krediti dhe informacionin e disponueshëm për mandatet e debitimit direkt që janë transferuar;

b) të dërgojë tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës dhe te konsumatori, informacionin e disponueshëm në lidhje me transfertat e kreditit periodike në mbërritje dhe mandatet e debitimeve direkte të iniciuara nga kreditori dhe të ekzekutuara në llogarinë e pagesës së konsumatorit në 13 muajt e mëparshëm;

c) të ndalojë pranimin e debitimeve direkte dhe transfertave të kreditit në mbërritje, me efekt nga data e specifikuar në autorizim, në rastet kur ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk siguron një sistem për ridrejtimin e automatizuar të transfertave të kreditit në mbërritje dhe debitimeve direkte në llogarinë e pagesës të mbajtur nga konsumatori me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës;

d) të anulojë urdhërpagesat periodike, me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

e) të transferojë çdo balancë kreditore të mbetur drejt llogarisë së pagesës të hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar nga konsumatori; dhe

f) të mbyllë llogarinë e pagesës të mbajtur me ofruesin transferues të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar nga konsumatori me paraqitjen e konsumatorit tek ofruesi transferues i shërbimit të pagesës.

Neni 12

Detyrimet e ofruesit transferues të shërbimit të pagesave

1. Ofruesi transferues i shërbimit të pagesës, pas marrjes së kërkesës nga ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, kryen veprimet e mëposhtme, nëse parashikohet në autorizimin e konsumatorit:

a) dërgon tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës informacionin e parashikuar në nenin 11, shkronjat "a" dhe "b", të kësaj rregulloreje, brenda 5 (pesë) ditëve pune;

b) ndalon pranimin e transfertave të kreditit në mbërritje dhe të debitimeve direkte në llogarinë e pagesës, me efekt nga data e specifikuar në autorizim, në rastet kur ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk siguron një sistem për ridrejtimin e automatizuar të transfertave të kreditit në mbërritje dhe debitimeve direkte në llogarinë e pagesës të mbajtur ose të hapur nga konsumatori me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës. Ofruesi i shërbimit të pagesave informon paguesin ose përfituesin e pagesës për arsyen e mospranimit të transaksionit të pagesës;

c) anulon urdhërpagesat periodike, me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

d) transferon çdo balancë (tepricë) kreditore (pozitive) të mbetur nga llogaria e pagesës, në llogarinë e pagesës të hapur ose të mbajtur me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës në datën e specifikuar në autorizim;

e) pa cenuar kërkesat e ligjit "Për shërbimet e pagesave" lidhur me zgjidhjen e kontratës, mbyll llogarinë e pagesës në datën e specifikuar në autorizim, nëse konsumatori nuk ka detyrime të papaguara në atë llogari pagese dhe me kusht që veprimet e renditura në shkronjat "a", "b" dhe "d" të këtij neni janë përmbushur. Ofruesi i shërbimit të pagesave informon menjëherë konsumatorin kur detyrime të tilla të papaguara pengojnë mbylljen e llogarisë së pagesës së konsumatorit.

Neni 13

Detyrime të tjera të ofruesit marrës të shërbimit të pagesave

1. Ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e informacionit të kërkuar nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës siç referohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje dhe në përputhje me autorizimin e konsumatorit, kryen veprimet e mëposhtme, deri në masën që i lejon informacioni i siguruar nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesave dhe/ose konsumatori:

a) aktivizon urdhërpagesat periodike për transferta krediti, të kërkuara nga konsumatori dhe i ekzekuton ato me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

b) kryen përgatitjet e nevojshme për të pranuar debitimet direkte dhe i pranon ato me efekt nga data e specifikuar në autorizim;

c) kur është e nevojshme, informon konsumatorët për të drejtat e tyre, në përputhje me kërkesat e nenit 15, pika 5, shkronja "a", të rregullores 50/2021, "Për debitimin direkt";

d) informon paguesit e specifikuar në autorizim dhe që kryejnë pagesa periodike nëpërmjet transfertave të kreditit në llogarinë e pagesës së konsumatorit mbi detajet e llogarisë së pagesës së konsumatorit pranë ofruesit marrës të shërbimit të pagesës dhe iu dërgon paguesve një kopje të autorizimit të konsumatorit. Nëse ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, nuk ka të gjitha informacionet që i duhen për të informuar paguesin, i kërkon konsumatorit ose ofruesit transferues të shërbimit të pagesës, të sigurojë informacionin që mungon;

e) informon përfituesit e pagesës të specifikuar në autorizim dhe që përdorin debitimet direkte për të tërhequr fonde nga llogaria e pagesës së konsumatorit, mbi detajet e llogarisë së pagesës së konsumatorit me ofruesin marrës të shërbimit të pagesës dhe datën nga e cila do të ekzekutohen debitimet direkte nga ajo llogari pagese dhe u

siguron përfituesve të pagesës një kopje të autorizimit të konsumatorit. Nëse ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, nuk ka të gjitha informacionet që i duhen për të informuar përfituesin e pagesës, i kërkon konsumatorit ose ofruesit transferues të shërbimit të pagesës, të sigurojë informacionin që mungon.

2. Konsumatori mund të zgjedhë të sigurojë personalisht informacionin e parashikuar në pikën 1, shkronjat "d" dhe "e", të këtij neni, për paguesit ose përfituesit e pagesës në vend që të sigurojë autorizimin përkatës në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje, tek ofruesi marrës i shërbimit të pagesës. Në këtë rast, ofruesi marrës i shërbimit të pagesave do t'i sigurojë konsumatorit, brenda afatit kohor të specifikuar në pikën 1 të këtij neni, një njoftim me shkrim, në letër ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, mbi detajet e llogarisë së pagesës dhe datën e fillimit të specifikuar në autorizim nga konsumatori.

3. Pa rënë ndesh me parashikimet e nenit 61, pika 2, të ligjit "Për shërbimet e pagesave", ofruesi transferues i shërbimit të pagesës nuk bllokon instrumentet e pagesës para datës së përcaktuar në autorizimin e konsumatorit.

Neni 14

Tarifat e lidhura me shërbimin e transferimit

1. Ofruesi transferues dhe ofruesi marrës i shërbimeve të pagesave, në rastin e shërbimit të transferimit, u mundësojnë konsumatorëve akses falas në informacionin e tyre personal në lidhje me urdhërpagesat periodike për transferta krediti ekzistuese dhe debitimet direkte, të mbajtura nga ofruesit e shërbimit të pagesës.

2. Ofruesi transferues i shërbimit të pagesës siguron informacionin e kërkuar nga ofruesi marrës i shërbimit të pagesës, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 12 të kësaj rregulloreje, pa ngarkuar me tarifa konsumatorin ose ofruesin marrës të shërbimit të pagesës.

3. Çdo tarifë, nëse aplikohet, që i ngarkohet konsumatorit nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës për mbylljen e llogarisë së pagesës të mbajtur me të, përcaktohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 48, pikat 2 dhe 4 të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

4. Çdo tarifë, nëse aplikohet, që i ngarkohet konsumatorit nga ofruesi transferues i shërbimit të pagesës ose ofruesi marrës i shërbimit të pagesës për shërbimet e ofruara në përputhje me nenin 11 deri në nenin 13 të kësaj rregulloreje, përveç atyre të përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me kostot aktuale të mbartura nga ofruesi i shërbimit të pagesave.

Neni 15

Humbja financiare për konsumatorët

1. Çdo humbje financiare, përfshirë tarifat dhe interesat, të pësuara nga konsumatori si rezultat i drejtpërdrejtë i mosrespektimit nga një ofrues i shërbimit të pagesave pjesëmarrës në procesin e transferimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 11 deri në 13 të kësaj rregulloreje, do të rimbursohet pa vonesë nga i njëjti ofrues i shërbimit të pagesave.

2. Përgjegjësia e përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk do të zbatohet në rast të rrethanave jonormale dhe të paparashikueshme, që dalin përtej kontrollit të ofruesit të shërbimit të pagesave, që apelon për ekzistencën e këtyre rrethanave, pasojat e të cilave nuk mund të ishin shmangur pavarësisht nga gjithë kujdesi i treguar ose në rastet kur një ofrues i shërbimit të pagesave është i detyruar nga detyrime të tjera ligjore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 16

Informacioni në lidhje me shërbimin e transferimit

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave vënë në dispozicion të konsumatorëve informacionin e mëposhtëm në lidhje me procesin e transferimit:

a) rolin e ofruesit transferues të shërbimit të pagesës dhe rolin e ofruesit marrës të shërbimit të pagesës për secilin hap të procesit të transferimit;

b) afatin kohor për përfundimin e hapave përkatës;

c) tarifat, nëse ka, të ngarkuara për procesin e transferimit;

d) çdo informacion që do t'i kërkohet konsumatorit të sigurojë; dhe

e) procedurat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

2. Informacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni duhet të jetë i disponueshëm falas dhe duhet t'u ofrohet konsumatorëve sipas kërkesës:

a) në letër ose me anë të një mjeti tjetër të qëndrueshëm komunikimi në të gjitha ambientet e ofruesit të shërbimit të pagesave të arritshëm për konsumatorët;

b) të jetë i disponueshëm në formë elektronike në faqen zyrtare të internetit të ofruesit të shërbimit të pagesave, në çdo kohë.

KREU IV

KËRKESA PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE

(shtuar Kreu me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Neni 17

Krahasueshmëria, transparenca e tarifave dhe transferimi i llogarive të pagesave me shërbime bazike

Kërkesat e kreut I, II dhe III të kësaj rregulloreje për llogarinë e pagesave, zbatohen në të njëjtën mënyrë nga bankat, edhe për llogarinë e pagesave me shërbime bazike, në zbatim të kërkesave të nenit 14 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".

Neni 18

Metodologjia e përllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike

Bankat, në përllogaritjen e tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, siç parashikohet në nenin 8, pika 3 të ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike", bazohen në nivelin mesatar të tarifës së aplikuar nga banka, për të njëjtat shërbime të ofruara nëpërmjet një llogarie pagesash dhe në çdo rast tarifa e arsyeshme nuk tejkalon 50% të këtij niveli mesatar.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

(Rinumërtuar Kreu me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Neni 19

Ankesat e konsumatorëve

(Rinumërtuar neni, ndryshuar titulli dhe shtuar togfjalësh me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Ofruesit e shërbimeve të pagesave marrin masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 93 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", për zgjidhjen e ankesave të

konsumatorëve, përfshirë edhe ankesat në lidhje me llogarinë e pagesave me shërbime bazike.

Neni 20

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

(Rinumërtuar neni dhe shtuar togfjalësh me Vendimin nr. 29, datë 8.5.2024)

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në ligjin "Për bankat", në ligjin "Për shërbimet e pagesave", në ligjin "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike" dhe në aktet e tjera nënligjore, në zbatim të tyre.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKS NR. 1
DOKUMENT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT

Ofruesi i shërbimeve të pagesave: _____
Emri i konsumatorit: _____
Data: _____

• Ky dokument ju informon për tarifat për përdorimin e shërbimeve kryesore të lidhura me llogarinë e pagesës. Kjo do t'ju ndihmojë të krahasoni këto tarifa me ato të llogarive të tjera.
• Tarifat mund të zbatohen gjithashtu për përdorimin e shërbimeve të lidhura me llogarinë të cilat nuk janë të listuara këtu. Informacioni i plotë është në dispozicion në [specifikoni emrat e dokumenteve përkatëse parakontraktore dhe kontraktore].
• Një fjalor i termave të përdorur në këtë dokument është në dispozicion falas.

Shërbimi	**Tarifa**
Shërbime të përgjithshme të llogarisë	
[shërbimi kryesor] Përfshin një **paketë shërbimesh** të përbërë nga: Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas.	**[●]**
Pagesat (me përjashtim të kartave)	
	[●]
Kartat dhe tërheqjet në para fizike	
	[●]
Kredi kufi dhe shërbimet përkatëse	
	[●]
Shërbime të tjera	
	[●]

Paketa e shërbimeve	Tarifa
	[●] **[●]**
Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas.	

Informacion mbi shërbimet shtesë Informacion mbi tarifat për shërbimet që tejkalojnë sasinë e shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve (me përjashtim të tarifave të renditura më sipër)	
Shërbime	**Tarifa**
[emri tregtar *(brand name)]*	**[●]**

Treguesi gjithëpërfshirës i kostos	**[●]**

SHËNIME SHPJEGUESE PËR PLOTËSIMIN E "DOKUMENTIT QË PËRMBAN INFORMACION MBI TARIFAT"

Seksioni 1: Kërkesa të përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin modelin/formatin e "Dokumentit që përmban informacion mbi tarifat" siç përcaktohet në këtë aneks dhe e plotësojnë atë në mënyrën e përcaktuar në seksionet 2 deri në 13 të shënimeve shpjeguese.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk modifikojnë modelin/formatin e "Dokumentit që përmban informacion mbi tarifat" në plotësimin e tij, përveç sa parashikohet në këtë aneks. Në veçanti, ofruesit e shërbimeve të pagesave ndjekin rendin e informacionit, titujve dhe nëntitujve të përcaktuar në këtë model/format.

Dokumenti që përmban informacion mbi tarifat:

a) paraqitet në format portret A4;

b) ka titullin "Dokument që përmban informacion mbi tarifat" në krye të faqes së parë;

c) shkrimi i përdorur të jetë "*Times New Roman*" ose një lloj tjetër i ngjashëm me të, me madhësi shkrimi 11, me përjashtim të titullit "Dokument që përmban informacion mbi tarifat", për të cilin përdoret madhësi shkrimi 16 të theksuar *(bold)*; madhësi shkrimi 14 të theksuar *(bold)* për titujt, dhe madhësi shkrimi 12 të theksuar *(bold)* për nëntitujt, përveçse nëse kërkohet një rritje në madhësinë e shkrimit ose përdorimi i shkrimit *"Braille"* për personat me shikim të dëmtuar sipas ligjit, ose siç bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave;

d) paraqitet bardh e zi, me përjashtim të logos së ofruesit të shërbimeve të pagesave që mund të paraqitet me ngjyra, siç përcaktohet në seksionin 2;

e) i ka faqet e tij të numërtuara.

3. Ofruesi i shërbimeve të pagesave siguron një dokument të veçantë që përmban informacion mbi tarifat në lidhje me secilën prej llogarive të pagesave që u ofron konsumatorëve.

4. Në rastet kur një ofrues i shërbimeve të pagesave u ofron konsumatorëve vetëm një llogari pagese që mund të kombinohet me paketa të ndryshme të shërbimeve të përmendura në pikën 4 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave mund të paraqesë më shumë se një dokument që përmban informacion mbi tarifat në lidhje me atë llogari, me kusht që secili dokument që përmban informacion mbi tarifat të përmbajë të paktën një paketë.

Seksioni 2: Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave do të jetë e një madhësie 2.5 cm x 2.5 cm dhe paraqitet majtas në krye të tabelës sipas këtij aneksi.

2. Logoja mund të paraqitet me ngjyra ose bardh e zi. Kur shtypet ose fotokopjohet bardh e zi, logoja duhet të jetë e qartë dhe e lexueshme.

Seksioni 3: Emri i ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Emri i ofruesit të shërbimeve të pagesave që ofron shërbimin e llogarisë përfshihet me shkronja të theksuara *(bold)* dhe majtas.

Seksioni 4: Emri i konsumatorit

1. Emri i konsumatorit përfshihet me shkronja të theksuara (bold), të vendosur në të majtë dhe poshtë emrit të ofruesit të shërbimeve të pagesave.

Seksioni 5: Data

1. Data kur ofruesi i shërbimit të pagesës ka përditësuar për herë të fundit dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, përfshihet duke përdorur llojin e shkrimit të përcaktuar në shkronjën "d", pika 2 e seksionit 1, të vendosur në të majtë dhe poshtë emrit të konsumatorit.

Seksioni 6: Deklarata hyrëse

1. Teksti i deklaratës hyrëse i përcaktuar në model/format riparaqitet në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, duke përdorur hapësirën e rreshtit 1.15, 0 *pt* para dhe 10 *pt* pas tekstit.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të zëvendësojnë kllapat katrore me emrat e dokumenteve përkatëse parakontraktore dhe kontraktore.

Seksioni 7: Tabela "Shërbimi dhe Tarifa"

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave rendisin shërbimet që janë të përfshira në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron shërbime të tilla, dhe tarifat e tyre përkatëse në tabelën mbi shërbimet dhe tarifat si më poshtë:

a) shërbimet të futen në kolonën "Shërbimi", majtas, me shkronja të theksuara *(bold);*

b) secili shërbim të renditet vetëm një herë dhe të shfaqet nën nëntitujt përkatës të paraqitur në tabelë, siç është ofrimi ose mirëmbajtja e llogarisë, të cilët renditen në nëntitullin "Shërbime të përgjithshme të llogarisë";

c) tarifat që korrespondojnë me shërbimet të shfaqen në kolonën "Tarifa", djathtas;

d) kur tarifa ngarkohet bazuar në një frekuencë përdorimi dhe jo mbi bazën e një përdorimi të vetëm, frekuenca të tregohet në kolonën "Tarifa", majtas, e shoqëruar nga tarifa përkatëse për atë periudhë djathtas; tarifa totale vjetore do të shfaqet në rreshtin poshtë shpeshtësisë, me shkronjat e theksuara *(bold)*, dhe duke përdorur "Tarifat totale vjetore" me tarifën përkatëse djathtas;

e) hapësira e rreshtit duhet të jetë e vetme (*single*), 0 *pt* para dhe 0 *pt* pas çdo shërbimi dhe tarife.

2. Në rastet kur asnjë nga shërbimet e ofruara nga një ofrues i shërbimeve të pagesave, i cili do të korrespondonte me një nëntitull, nuk përfshihet në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese, i gjithë rreshti që lidhet me atë nëntitull fshihet, përfshirë titullin e nëntitullit.

3. Në rastet kur ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk ofrojnë një ose më shumë shërbime nga lista përfundimtare e shërbimeve më përfaqësuese të përmendura në pikën 1 të nenit 5, ose kur shërbimi nuk është i disponueshëm në llogari, do të përdoret "shërbimi nuk është i disponueshëm".

4. Në rastet kur tarifa të veçanta ngarkohen/tarifohen në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë, në kolonën "Tarifa" të atij shërbimi edhe në një rresht të veçantë, një përshkrim të secilit rast, kanal komunikimi ose kusht të ngarkimit të tarifës ("llojet e tarifave"):

a) për raste të ndryshme të ngarkimit të tarifave të sigurimit të të njëjtit shërbim, të tilla si një tarifë fillestare dhe tarifat e ekzekutimit pasues për të njëjtin shërbim;

b) për kanale të ndryshme përmes të cilave kërkohet, ofrohet ose sigurohet i njëjti shërbim, të tilla si përmes telefonit, degës së ofruesit ose internetit;

c) në varësi të përmbushjes së një kushti specifik për të njëjtin shërbim, siç është respektimi i një shume minimale ose maksimale të kufirit për transferimet kredituese ose tërheqjet e parave, përshkrimi do të pasqyrohet në të majtë dhe tarifa do të pasqyrohet në të djathtë.

5. Kur tarifat ngarkohen në varësi të kombinimit të disa llojeve të tarifave, të tilla si tarifat që ndryshojnë sipas kanalit dhe më pas ndahen më tej në varësi të përmbushjes së një shume të kufirit, ofruesit e shërbimeve të pagesave, përveç zbatimit të pikës 4, pasqyrojnë në të djathtë përshkrimin e secilit lloj të tarifës shtesë.

Seksioni 8: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuara si pjesë e tarifave nën nëntitullin "Shërbime të përgjithshme të llogarisë"

1. Kur një paketë shërbimesh të lidhura me një llogari pagese vendoset si pjesë e tarifave nën nëntitullin "Shërbime të përgjithshme të llogarisë", të gjitha shërbimet e përfshira në paketë, pavarësisht nëse ato përfshihen në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, do të pasqyrohen në nëntitullin e tabelës "Shërbime të përgjithshme të llogarisë", në rreshtin për paketën e shërbimeve.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacion mbi tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa e shërbimeve siç përcaktohet në seksionin 10.

3. Kur numri i të gjitha shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve nuk është i kufizuar, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën në fund të rreshtit "Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas".

4. Kur një paketë shërbimesh nuk ofrohet në llogari dhe kur paketa e shërbimeve tarifohet veçmas nga çdo tarifë për shërbimet e përgjithshme të llogarisë, hiqet i gjithë rreshti për paketën e shërbimeve.

Seksioni 9: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuara veçmas nga tarifat nën nëntitullin "Shërbime të përgjithshme të llogarisë"

1. Kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë një paketë shërbimesh të lidhura me një llogari pagese dhe paketa tarifohet veçmas nga çdo tarifë nën nëntitullin "Shërbime të përgjithshme të llogarisë", siç referohet në tabelën e shërbimeve dhe tarifave, ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacionin e mëposhtëm në tabelën e paketës së shërbimeve:

a) një listë të të gjitha shërbimeve të përfshira në paketë, pavarësisht nëse ato përfshihen në listën përfundimtare të shërbimeve më përfaqësuese të lidhura me një llogari pagese të parashikuar në pikën 1 të nenit 5;

b) sasinë e secilit shërbim të mbuluar nga tarifa e paketës, e cila mund të jetë një numër ose një tregues se numri i shërbimeve nuk është i kufizuar;

c) tarifa e paketës, në kolonën "Tarifa", djathtas.

2. Kur paketa është e tarifuar bazuar në një frekuencë përdorimi, frekuenca shfaqet në kolonën "Tarifa", majtas , me tarifën totale vjetore të shfaqur në rreshtin poshtë frekuencës, me shkronja të theksuara dhe duke përdorur "Tarifa totale vjetore".

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë informacion mbi tarifën shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa e shërbimeve siç parashikohet në seksionin 10.

4. Kur numri i të gjitha shërbimeve në paketë nuk është i kufizuar, ofruesit e shërbimeve të pagesave heqin deklaratën në fund të tabelës që lexon "Shërbimet përtej këtyre sasive do të tarifohen veçmas".

5. Kur më shumë se një paketë, sipas parashikimit të pikës 1 të këtij seksioni, përfshihet në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat, ofruesit e shërbimeve të

pagesave duhet të sigurojnë informacionin sipas këtij seksioni për secilën paketë në një tabelë të veçantë, duke treguar emrin tregtar (*brand name*) të paketës së shërbimeve, nëse aplikohet.

6. Në rastet kur paketa e shërbimeve nuk ofrohet së bashku me llogarinë, ose kur paketa e shërbimeve ngarkohet si pjesë e tarifës për ndonjë shërbim të përgjithshëm të llogarisë, ofruesit e shërbimeve të pagesave fshijnë të gjithë tabelën.

Seksioni 10: Tabela mbi tarifat shtesë për shërbimet që tejkalojnë sasinë e mbuluar nga paketat e shërbimeve të lidhura me një llogari pagese

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përfshijnë në këtë tabelë informacionin mbi tarifat shtesë për çdo shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga një paketë e përmendur në seksionet 8 dhe 9, nëse ky informacion nuk përfshihet në tabelën e shërbimeve dhe tarifave, ose kur tarifa përkatëse për shërbimin është e ndryshme nga ajo që tregohet në tabelë.

2. Kur ofruesit e shërbimeve të pagesave ofrojnë më shumë se një paketë dhe tarifat shtesë të përmendura në pikën 1 të këtij seksioni ndryshojnë në varësi të paketës, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të rendisin tarifat e ndryshme veçmas për secilën paketë dhe të përdorin emrin tregtar (*brand name*) të paketës, nëse aplikohet.

3. Në plotësimin e kësaj tabele, ofruesit e shërbimeve të pagesave ndjekin të njëjtën paraqitje dhe strukturë siç përcaktohet në këtë aneks, kur është e zbatueshme.

4. Kur dokumenti që përmban informacion mbi tarifat nuk përfshin ndonjë informacion mbi paketat e shërbimeve, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë tabelën e përmendur në pikën 1 të këtij seksioni.

Seksioni 11: Treguesi gjithëpërfshirës i kostos

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave shfaqin treguesin gjithpërfshirës të kostos që përmbledh koston e përgjithshme vjetore të llogarisë së pagesës, në një tabelë të veçantë.

Seksioni 12: Emrat tregtarë (*brand names*)

1. Kur përdoret një emër marke, emri i markës duhet të pasojë direkt pas emrit të shërbimit, duke përdorur llojin e shkrimit të përcaktuar në shkronjën "d", pika 2 të seksionit 1 dhe në kllapa katrore.

Seksioni 13: Përdorimi i mjeteve elektronike

1. Kur dokumenti që përmban informacion mbi tarifat sigurohet me mjetet elektronike, ofruesit e shërbimeve të pagesave, me kusht që në të njëjtën kohë konsumatorit t'i sigurohet një kopje e dokumentit që përmban informacion mbi tarifat në përputhje me formularin e përcaktuar në këtë aneks dhe të plotësuar siç përcaktohet në seksionet 2 deri 12, mund të modifikojnë formularin vetëm sipas mënyrave të mëposhtme:

a) pa rënë ndesh me shkronjën "d", pika 2, të seksionit 1, rritet madhësia e shkrimit, me kusht që të ruhet proporcioni i madhësive siç përcaktohet në pikën 2 të seksionit 1;

b) kur përmasat e mjeteve elektronike janë të tilla që përdorimi i disa tabelave dhe kolonave do ta vështirësonte leximin e dokumentit që përmban informacion mbi tarifat, përdoret një kolonë e vetme ose një tabelë e vetme nëse ruhet renditja e informacionit, titujve dhe nëntitujve;

c) të përdoren mjete elektronike, me kusht që titulli i dokumentit që përmban informacion mbi tarifat, deklaratat hyrëse, titujt dhe nëntitujt, të shfaqen në mënyrë të dukshme dhe të ruhet renditja e informacionit.

Përdorimi i mjeteve elektronike të përmendura në shkronjën "c" të pikës 1 nuk duhet të ndikojë apo shpërqendrojë konsumatorin nga informacioni i paraqitur në dokumentin që përmban informacion mbi tarifat.

ANEKS NR. 2
PASQYRA MBI TARIFAT E APLIKUARA

[Ofruesi i shërbimeve të pagesave]
[Detajet e kontaktit të ofruesit të shërbimeve të pagesave]

[Emri i konsumatorit]
[Detajet e kontaktit]

Llogaria	
Numri i identifikimit të llogarisë	
Periudha	Nga – deri
Data	

• Ky dokument ju ofron një përmbledhje të të gjitha tarifave për shërbimet e lidhura me llogarinë tuaj të pagesës gjatë periudhës së treguar më sipër.
• Ai gjithashtu ju informon për çdo interes që mund të keni paguar ose fituar gjatë kësaj kohe.
• Informacioni mbi transaksionet individuale dhe gjendjen e llogarisë mund të gjendet në pasqyrat e gjendjes së llogarisë.

Përmbledhje e tarifave dhe interesave

Tarifat totale të paguara (paketa totale e tarifave të shërbimeve dhe tarifat totale të paguara)	**[●]**
Interesi total i paguar	**[●]**
Interesi total i fituar	**[●]**
Treguesi gjithëpërfshirës i kostos	**[●]**

Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari

Shërbimi		**Tarifa**		
Shërbimi	**Numri i herëve që është përdorur shërbimi**	**Tarifa për njësi**	**Numri i herëve që u tarifua tarifa**	**Total**
Shërbime të përgjithshme të llogarisë				
[●] Përfshin një **paketë shërbimesh të** përbërë nga: Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas	.			**[●]**
Pagesat (me përjashtim të kartave)				
				[●]
Kartat dhe *cash*-i				
				[●]
Kredi kufi				
				[●]
Shërbime të tjera				
				[●]

Tarifat totale të paguara	**[●]**

Detaje të tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve

Paketa e shërbimeve	**Tarifa**	**Numri i herëve që u tarifua tarifa**
"Shërbimi i paketës" [emri i markës, nëse aplikohet] Përfshin:	**[●]**	**[●]**
Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas.		

Detaje të interesit të paguar në llogari

	Norma e interesit	**Interesi**
		[●]
Interesi total i paguar		**[●]**

Detaje të interesit të fituar nga llogaria

	Norma e interesit	**Interesi**
"Emri i llogarisë"		**[●]**
Interesi total i fituar		**[●]**

Informacion shtesë **[●]**

SHËNIME SHPJEGUESE PËR PLOTËSIMIN E "PASQYRËS MBI TARIFAT E APLIKUARA"

Seksioni 1: Kërkesa të përgjithshme

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave përdorin modelin/formatin e "Pasqyrës mbi tarifat e aplikuara" siç përcaktohet në këtë aneks dhe e plotësojnë atë në mënyrën e përcaktuar në seksionet 2 deri në 18 të shënimeve shpjeguese.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave nuk e ndryshojnë tabelën për pasqyrën e tarifave, gjatë plotësimit të saj, përveç sa parashikohet në këtë aneks. Në mënyrë të veçantë, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të ndjekin renditjen e informacionit, titujt dhe nëntitujt e paraqitur në tabelë.

3. Pasqyra mbi tarifat e aplikuara:

a) paraqitet në format portret A4;

b) përmban titullin "Pasqyra mbi tarifat e aplikuara" në krye të faqes së parë, në qendër;

c) përdor llojin e shkrimit "*Times New Roman*" ose një tjetër lloj shkrimi të ngjashëm me të dhe madhësinë e shkronjës 11, me përjashtim të titullit "Pasqyra mbi tarifat e aplikuara", për të cilin përdoret madhësi e shkronjës 16, të theksuar (*bold*); madhësi e shkronjës 14, të theksuar (*bold*) për titujt dhe madhësinë e shkronjës 12, të theksuar (*bold*) për nëntitujt, në rast se nuk kërkohet rritja e madhësisë së shkronjës apo përdorimi i shkrimit "*Braille*" për personat me shikim të dëmtuar, sipas ligjit ose siç bihet dakord ndërmjet konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve të pagesave;

d) paraqitet bardh e zi, me përjashtim të logos së ofruesit të shërbimeve të pagesave, që mund të paraqitet me ngjyra, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij seksioni;

e) i ka faqet e numërtuara.

Seksioni 2: Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave

1. Logoja e ofruesit të shërbimeve të pagesave do të jetë e një madhësie 2.5 cm x 2.5 cm dhe paraqitet e pozicionuar majtas në krye të tabelës sipas këtij aneksi.

2. Logoja mund të paraqitet me ngjyra ose bardh e zi. Logoja nëse printohet bardh e zi, duhet të jetë qartësisht e lexueshme.

Seksioni 3: Emri dhe detajet e kontaktit të ofruesit të shërbimit të pagesave për shërbimin e llogarisë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me emrin e ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë (*account provider*) me shkronja të theksuara (*bold*), majtas.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me detajet e tyre të kontaktit, të tilla si adresa, numri i telefonit, adresa e postës elektronike, numri i faksit, adresa e faqes së internetit dhe personi/pika e kontaktit, që mbajtësi i llogarisë së pagesave mund të përdorë për korrespondencat e ardhshme.

Këto detaje të kontaktit do të paraqiten majtas.

Seksioni 4: Emri dhe detajet e kontaktit të mbajtësit të llogarisë së pagesave

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me emrin e mbajtësit të llogarisë së pagesave.

Ky emër do të paraqitet me shkronja të theksuara (*bold*), majtas.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë hapësirat ndërmjet kllapave katrore me adresën e mbajtësit të llogarisë së pagesave.

Kjo adresë do të paraqitet majtas dhe, me përjashtim të shkronjës së parë të çdo fjale, me shkronja të vogla.

Seksioni 5: Emri dhe identifikimi i llogarisë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin emrin e llogarisë së pagesave.

Ky emër do të paraqitet me shkronja të theksuara (*bold*), majtas dhe drejtpërdrejt pas fjalëve përkatëse.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin detaje që identifikojnë llogarinë e pagesave, të tilla si kodi identifikues i biznesit – kodi BIC (*Bank Identifier Code*), kodi identifikues ndërkombëtar i numrit të llogarisë së pagesës – kodi IBAN (*International Bank Account Number*), kodi kombëtar i numrit të llogarisë së pagesës – kodi BBAN dhe kodi kombëtar identifikues biznesi – kodi KIB (*national sort code*).

Këto detaje do të paraqiten majtas.

Seksioni 6: Periudha kalendarike

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në rreshtin "periudha", majtas, periudhën kalendarike që mbulohet nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara.

Seksioni 7: Data

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në rreshtin "Data", majtas, datën kalendarike kur ata kanë ofruar pasqyrën mbi tarifat e aplikuara.

Seksioni 8: Pasqyra hyrëse

1. Teksti i pasqyrës hyrëse, të specifikuar në tabelë, do të riprodhohet si i tillë në pasqyrën mbi tarifat e aplikuara, duke përdorur hapësirë mes rreshtash prej 1.15, 0 *pt* përpara dhe 10 *pt* pas tekstit.

Seksioni 9: Përmbledhja e tarifave dhe interesave

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin me shkronja të theksuara (*bold*) dhe djathtas, shumat totale të tarifave dhe interesave, që do të përfshihen në katër tabelat e veçanta poshtë titullit "Përmbledhje e tarifave dhe interesave".

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përdorin formulimin "nuk aplikohen interesa", me shkronja të vogla dhe djathtas, në rast se për një llogari specifike nuk paguhet interes.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vendosin "0" në tabelën përkatëse, në rast se aplikohet interes por, për periudhën specifike, ai është i barasvlershëm me zero.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin treguesin gjithëpërfshirës të kostos, i cili përmbledh koston e përgjithshme vjetore të llogarisë së pagesës në një tabelë të veçantë.

Seksioni 10: Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara për llogarinë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën me titull "Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari", të gjitha tarifat që zbatohen në periudhën e përcaktuar për shërbimet përkatëse.

Tarifat për hapjen ose mirëmbajtjen e llogarisë do të paraqiten poshtë nëntitullit "Shërbime të përgjithshme të llogarisë."

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shërbimet në nënkolonën "Shërbimi", majtas, me shkronja të theksuara (*bold*), duke përdorur hapësirë të vetme (single) midis rreshtave 0 *pt* përpara dhe 0 *pt* pas çdo shërbimi.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën "Numri i herëve që është përdorur shërbimi" të pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, numrin e herëve që çdo shërbim është përdorur gjatë periudhës përkatëse, duke përdorur shkrimin e kërkuar sipas pikës 3, shkronja "d" të seksionit 1.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta lënë bosh nënkolonën "Numri i herëve që është përdorur shërbimi" në rastet kur shërbimi është përdorur, por ofruesi i shërbimeve të pagesave nuk ka ngarkuar tarifë për atë shërbim.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën "Tarifa për njësi" strukturën e tarifës për njësi dhe koston për secilin nga shërbimet e përdorura.

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin djathtas në nënkolonën "Numri i herëve që u tarifua shërbimi" të pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, numrin e herëve që çdo shërbim është tarifuar gjatë periudhës përkatëse. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta tregojnë këtë në nënkolonën përkatëse, duke përdorur formulimin "tarifë jo e tarifuar/ngarkuar", në rastet kur shërbimi është përdorur, por nuk është ngarkuar/tarifuar tarifë për të.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në nënkolonën "Total" shumën totale të tarifave të paguara për përdorimin e atij shërbimi gjatë periudhës përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*).

7. Në rastet kur një nëntitull nuk përmban asnjë shërbim, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë atë nëntitull. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë gjithashtu nëntitullin, në rastet kur mbajtësi i llogarisë së pagesave nuk ka përdorur asnjë nga shërbimet përtej sasive të treguara në paketën e shërbimeve gjatë periudhës përkatëse.

8. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shumën totale të tarifave të paguara nga një mbajtës i llogarisë së pagesave gjatë periudhës përkatëse në rreshtin "Tarifat totale të paguara", me shkronja të theksuara (*bold*).

Seksioni 11: Paraqitja e llojeve të tarifave

1. Në rastet kur ngarkohen/tarifohen tarifa të veçanta në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin, në tabelën "Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari" në kolonën "Shërbimi" të shërbimit përkatës, në një linjë të ndarë, një përshkrim të secilit rast të ngarkimit të tarifës, kanalit ose kushtit ("lloje të tarifave"):

a) për raste të ndryshme të ngarkimit të tarifave mbi ofrimin e të njëjtit shërbim, të tillë si një tarifë fillestare konfigurimi (*initial set-up fee*) dhe tarifa të mëtejshme ekzekutimi për të njëjtin shërbim;

b) për kanale të ndryshme, përmes të cilëve i njëjti shërbim kërkohet, përdoret apo ofrohet, si për shembull përmes telefonit, degës së ofruesit apo *online*;

c) në varësi të faktit nëse përmbushet apo jo një kusht i veçantë për të njëjtin shërbim, i tillë si zbatimi i një kufiri minimal apo maksimal për transferimet e kredive apo tërheqjet e *cash*-it.

Përshkrimi do të jetë i pasqyruar majtas dhe tarifat do të paraqiten djathtas në kolonën "Tarifa e njësisë".

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të vendosin djathtas përshkrimin e çdo lloji tarife shtesë, përveç zbatimit të pikës 5 të seksionit 10, në rastet kur tarifat ngarkohen në varësi të kombinimit të shumë llojeve të tarifave, siç janë tarifat që ndryshojnë nga kanali dhe më pas ndahen edhe më tej në varësi të faktit nëse është respektuar apo jo një shumë-kufi.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin tarifat e zbatuara gjatë secilës periudhë, duke shtuar rreshta të rinj në kolonën "Tarifa e njësisë", në rastet kur tarifa ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse.

Seksioni 12: Paraqitja e paketave të shërbimeve të tarifuara si pjesë e tarifave, poshtë nëntitullit "Shërbime të përgjithshme të llogarisë"

1. Në rastet kur një paketë e shërbimeve të lidhura me një llogari të pagesave, ofrohet me llogarinë dhe tarifohet si pjesë e tarifave poshtë nëntitullit "Shërbime të përgjithshme të llogarisë", ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përfshijnë në tabelën "Pasqyrë e detajuar e tarifave të paguara në llogari", në rreshtin "Paketa e shërbimeve", informacionin mbi shërbimet e përfshira në paketë në kolonën "Shërbimi" dhe numrin e herëve që është përdorur paketa në kolonën "Numri i herëve që është përdorur shërbimi". Në kolonat poshtë "Tarifa", ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin tarifën e ngarkuar/tarifuar për paketën në tërësinë e saj, dhe numrin e herëve që tarifa e paketës është ngarkuar/tarifuar gjatë periudhës përkatëse, siç përcaktohet respektivisht në pikën 1 të seksionit 11. Rreshti do të fshihet, në rast se paketa e shërbimeve tarifohet veçmas nga tarifimi për shërbimet e përgjithshme të llogarisë.

2. Çdo tarifë që tarifohet për ndonjë shërbim, që tejkalon sasinë e mbuluar nga paketa, do të paraqitet në tabelën që rendit shërbimet dhe tarifat, siç parashikohet në seksionet 1 deri 11 të shënimeve shpjeguese.

3. Në rastet kur numri i shërbimeve të paketës nuk është i kufizuar, ose kur nuk janë tejkaluar sasitë e shërbimeve të mbuluara nga paketa, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën poshtë rreshtit "Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas".

Seksioni 13: Paraqitja e paketave të shërbimeve të lidhura me një llogari të pagesave të tarifuar veçmas nga tarifat poshtë nëntitullit "Shërbime të përgjithshme të llogarisë"

1. Në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ofron një paketë shërbimesh të lidhur me një llogari pagesash, së bashku me llogarinë, dhe ajo paketë është e tarifuar veçmas nga të gjitha tarifat poshtë nëntitullit "Shërbime të përgjithshme të llogarisë" për shërbimet e përgjithshme të llogarisë siç parashikohet në tabelën që rendit shërbimet dhe tarifat, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të përfshijnë në tabelën mbi paketën e shërbimeve informacionin e mëposhtëm:

a) në kolonën mbi paketën e shërbimeve, emrin e markës, nëse është e mundur, ose përmbajtjen e paketës, duke fshirë kllapat katrore;

b) në kolonën "Tarifa", tarifën e ngarkuar për paketën në tërësinë e saj për periudhën e pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, djathtas;

c) në kolonën e tretë, numrin e herëve që tarifa e paketës është ngarkuar gjatë periudhës përkatëse.

Çdo tarifë shtesë e ngarkuar për ndonjë shërbim që tejkalon sasinë e mbuluar nga tarifa e paketës do të paraqitet në tabelën mbi shërbimet dhe tarifat, siç përmendet në seksionet 10 dhe 11 të shënimeve shpjeguese.

2. Në rastet kur paketa tarifohet bazuar në një frekuencë të caktuar përdorimi, frekuenca do të paraqitet në kolonën "Tarifa", majtas, ndërsa kosto totale vjetore do të shfaqet në rreshtin që vjen menjëherë poshtë frekuencës së tarifimit, me shkronja të theksuara (*bold*) dhe duke përdorur formulimin "Kosto totale vjetore".

3. Në rastet kur paketa të ndryshme u nënshtrohen tarifave të ndryshme gjatë periudhës përkatëse, informacioni i paraqitur në pikën 1 do të ofrohet për secilën nga paketat në një tabelë më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë të gjithë tabelën, duke përfshirë titullin "Detaje të tarifave të përfshira në paketën e shërbimeve", nëse një paketë e shërbimeve nuk ofrohet bashkë me llogarinë, ose nëse paketa e shërbimeve e ofruar me llogarinë tarifohet/ngarkohet si pjesë e tarifës për çdo shërbim të përgjithshëm të llogarisë.

5. Në rastet kur numri i të gjitha shërbimeve të paketës nuk është i kufizuar, ose kur nuk janë tejkaluar sasitë e shërbimeve të mbuluara nga paketa e shërbimeve, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të fshijnë deklaratën poshtë tabelës ku shkruhet "Shërbimet përtej këtyre sasive janë tarifuar veçmas".

Seksioni 14: Detaje të interesit të paguar në llogari

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën "Detaje të interesit të paguar në llogari", interesin e paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara, aty ku është e aplikueshme.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin normën e interesit në kolonën "Norma e interesit" dhe si përqindje të zbatuar në bazë vjetore. Në rast se norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin çdo normë interesi që është aplikuar gjatë secilës periudhë në një rresht më vete.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në kolonën "Interesi", interesin e paguar nga një mbajtës i llogarisë së pagesave, të shprehur në monedhën e llogarisë, me shkronja të theksuara (*bold*). Nëse norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të tregojnë interesin e paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave, më vete, për secilën nga periudhat përkatëse, secili në një rresht më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin shumën totale të interesit, të paguar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*) në rreshtin "Interesi total i paguar".

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët "nuk aplikohet interes", me shkronja të vogla, majtas, me *bold*, në rreshtin "Interesi total i paguar", në rastet kur një mbajtës i një llogarie të pagesave nuk paguan interes, pasi nuk aplikohet interes mbi llogarinë.

Seksioni 15: Detaje të interesit të fituar nga llogaria

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën "Detaje të interesit të fituar nga llogaria", interesin e fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara, aty ku është e aplikueshme.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të plotësojnë fushën "Emri i llogarisë" me emrin e llogarisë përkatëse, me shkronja të theksuara (*bold*).

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin normën e interesit në kolonën "Norma e interesit" dhe si përqindje të aplikuar në bazë vjetore. Në rast se norma e

interesit ka ndryshuar gjatë periudhës përkatëse, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të rendisin çdo normë interesi që është aplikuar gjatë secilës periudhë në një rresht më vete.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në kolonën "Interesi", interesin e fituar nga një mbajtës i llogarisë së pagesave, të shprehur në monedhën e llogarisë, me shkronja të theksuara (*bold*). Nëse norma e interesit ka ndryshuar gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin interesin e fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave, më vete, për secilën nga periudhat përkatëse, secili në një rresht më vete. Në rastet kur aplikohet normë interesi, por, për periudhën specifike, ajo është e barabartë me zero, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin "0" në kolonën "Interesi".

5. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët "nuk aplikohet interes", me shkronja të vogla, majtas, në kolonën "Interesi", në rastet kur një llogari e veçantë nuk paguan interes, për arsye se nuk aplikohet interes mbi llogarinë.

6. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në rreshtin "Interesi total i fituar" me shkronja të theksuara (*bold)*, shumën totale të interesit, të fituar nga mbajtësi i llogarisë së pagesave gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara.

7. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin fjalët "nuk aplikohet interes", me shkronja të vogla (majtas), me shkronja të theksuara (*bold)*, në rreshtin "Interesi total i fituar", në rastet kur një llogari e veçantë nuk paguan interes për arsye se mbi atë llogari nuk aplikohet interes.

Seksioni 16: Informacion mbi shërbimet shtesë

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të paraqesin në tabelën "Informacion mbi shërbimet shtesë", çdo informacion shtesë që shkon përtej informacionit të parashikuar në seksionet 2 deri 15 dhe që është drejtpërsëdrejti i lidhur me shërbimet apo tarifat e paguara, ose interesin e ngarkuar apo të fituar, ose me normat e interesit të aplikuara, siç përcaktohet në nenin 7, pika 3, të kësaj rregulloreje gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyra mbi tarifat e aplikuara. Informacioni mbi shërbimet shtesë, i paraqitur në atë tabelë, do të përfshijë informacionin e kërkuar nga rregulloret në fuqi.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do të ndjekin modelin/formatin e paraqitjes së përcaktuar në këtë aneks, gjatë plotësimit të tabelës, nëse kjo është e aplikueshme.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do ta fshijnë këtë tabelë, nëse ata nuk do të ofrojnë llojin e informacionit, që specifikohet në pikën 1 të kësaj pike.

Seksioni 17: Emrat e markës

1. Në rastet kur përdoret një emër tregtar (*brand name*), ai do të pasqyrohet menjëherë pas emrit të shërbimit, duke përdorur standardin e shkrimit të përmendur në pikën 3, shkronja "d" të seksionit 1 dhe brenda kllapave katrore.

Seksioni 18: Përdorimi i mjeteve elektronike

1. Në rastet kur pasqyra mbi tarifat e aplikuara ofrohet përmes mjeteve elektronike, ofruesit e shërbimeve të pagesave, me kusht që në të njëjtën kohë konsumatorit t'i vihet në dispozicion një kopje e pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, në linjë me tabelën e paraqitur në aneks dhe të plotësuar siç përcaktohet në seksionet 2 deri 17, mund ta ndryshojnë tabelën vetëm në mënyrat e mëposhtme:

a) pa rënë ndesh me shkronjën "d", të pikës 3 të seksionit 1, mund të rrisin madhësinë e shkrimit, me kusht që të ruhet proporcioni i madhësive, siç paraqitet në seksionin 1, pika 3;

b) në rastet kur përmasat e mjeteve elektronike janë të tilla që, përdorimi i shumë tabelave dhe kolonave do ta vështirësonte leximin e pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, mund të përdorin një kolonë të vetme ose një tabelë të vetme, nëse ruhet rendi i informacionit, titujt dhe nëntitujt;

c) të përdorin mjetet elektronike, me kusht që titulli i pasqyrës mbi tarifat e aplikuara, titujt dhe nëntitujt, të shfaqen në mënyrë të dukshme dhe të ruhet rendi i informacionit.

2. Përdorimi i mjeteve elektronike, që përmendet në shkronjën "c", të pikës 1, nuk duhet të ndikojë apo shpërqendrojë konsumatorin nga informacioni që përmbahet në pasqyrën mbi tarifat e aplikuara.